

VENDIM
Nr.1641, datë 17.12.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS VOSKOP TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Voskop të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 43 (dyzet e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 212 (dyqind e dymbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Voskop për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Voskop		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-3, 206-209	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
4-10	Prona që përdoren në fushën social kulturore.	Në pronësi
11	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
12-17,210-212	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
18-19,22-24	Infrastrukturë, rrugë vendore	Në pronësi
25-32	Sistemi i funizimit me ujë të pijshëm.	Në pronësi
41-47	Prona që shërbejnë për shërbimin funeral.	Në pronësi
48-55	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
56,58,59,61,63,64,66	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë bujqësore produktive).	Në përdorim
57,62,65,70,74,80,84,87	Prona që përdoren në fushën e	Në pronësi

	bujqësisë dhe ushqimit (kanale të treta, tokë joproduktive).	
--	--	--